



BASHKIA BERAT

**RAPORTI I MONITORIMIT
TË ZBATIMIT TË BUXHETIT
Periudha Janar - Dhjetor 2023**

PËRMBAJTJA

1.	VËSHTRIM I PËRGGJITHSHËM	4
1.1.	SITUATA E NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE.....	4
1.2.	Baza ligjore për hartimin e raportit të ekzekutimit të buxhetit.....	6
1.3.	Buxheti vjetor dhe Ndryshimet e buxhetit.....	6
1.4.	Çështje të barazisë gjinore.....	9
1.5.	Opinione të auditit të brendshëm dhe të jashtëm.....	Error! Bookmark not defined.
2.	INFORMACION FINANCIAR	9
2.1.	REALIZIMI I TË ARDHURAVE	12
2.2.	SHPENZIMET	Error! Bookmark not defined.
2.2.1	Realizimi i planit të shpenzimeve të periudhës Janar - Dhjetor 2023 sipas Njësive Shpenzuese	30
2.2.2	Realizimi i planit të shpenzimeve të periudhës Janar - Dhjetor 2023 sipas Natyrës Ekonomike	31
	Informacion i detajuar mbi realizimin e investimeve	36
	Projektet e Investimeve me financim nga Buxheti i Bashkisë	37
	Projektet e Investimeve me fonde nga transfertat sektoriale për projektë të veçanta :.....	38
	Projektet e Investimeve me financim nga Buxheti i Shtetit	38
2.2.3	Realizimi i planit të shpenzimeve të periudhës Janar - Dhjetor 2023 sipas programeve buxhetore	40
2.2.3.1.	Analiza e detajuar e shpenzimeve sipas programeve buxhetore dhe treguesve të monitorimit të buxhetit	40
	Programi 01110 : Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	42
	Programi 03140 : Shërbimet e Policisë Vendore	45
	Programi 03280 : Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	47
	Programi 04220 : Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve	49
	Programi 04240 : Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	51
	Programi 04260 : Administrimi i pyjeve dhe kullotave	52
	Programi 04520 : Rrjeti rrugor rural	55
	Programi 05100 : Menaxhimi i mbetjeve	57
	Programi 06260 : Shërbime publike vendore	58
	Programi 06370 : Furnizimi me ujë dhe Kanalizime	60
	Programi 08130 : Sport dhe argëtim	63
	Programi 08220 : Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	64
	Programi 09120 : Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	67

Programi 09230: Arsimi i mesëm i përgjithshëm	69
Programi 10430 : Përkujdesja Sociale	74
Programi 10661 : Strehimi social	76
2.3 INFORMACION MBI DETYRIMET E PRAPAMBETURA DHE TË KRIJUARA	78
2.4 INFORMACIONI FINANCIAR SUPLEMENTAR	80
Treguesit Kyç Financiarë	80
ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim të brendshem dhe me financim të huaj"	85

1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

1.1.SITUATA E NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE

E shtrirë në Krahinën Malore të Shqipërisë Jugore dhe pjesërisht në Ultësirën Perëndimore në të dy anët e rrjedhës së mesme dhe të poshtme të lumit Osum, Bashkia Berat është një atraksion jo vetëm turistik, por edhe një njësi ekonomike me resurse të mëdha zhvillimi.

Ajo përfshin brenda juridiksionit të saj administrativ qytetin e Beratit, njësitë: Otlak, Velabisht, Roshnik, dhe Sinjë. Në total nga 7 njësi administrative.

Tregues të rëndësishëm statistikorë bazë të saj janë:

Sipërfaqja: Bashkia Berat ka një sipërfaqe totale 380 km² e cila klasifikohet në tokë bujqësore prej 170 km², (përfshirë këtu tokat e kultivuara dhe jo të kultivuara) dhe tokë natyrore 180 km²(përfshirë këtu pyjet dhe kullotat)

Karakteristika të veçanta kanë njësitë përbërëse të bashkisë pjesë e ish komunave si : Njësitë Otlak dhe Velabisht të cilat në sipërfaqen e tyre kanë më shumë tokë bujqësore, dhe njësitë Roshnik e Sinjë që kanë në strukturën e sipërfaqes së tyre teritoriale tokë bujqësore të fragmentarizuar me sipërfaqe më të madhe të tokës natyrore, dhe relief kodrinor malor.

Bashkia Berat përshkohet nga lumi i Osumit dhe është tepër e pasur me ujëra nëntokësore e burime ujore sipërfaqësore .

Sipërfaqja totale ujore është 9 km². Sipërfaqet banuara janë 4.63 km².

Industria dhe ekonomia shtrihen në një sipërfaqe prej 1.34 km².

Bashkia përshkohet nga 812 km rrugë

Qyteti i Beratit gjendet 58 m mbi nivelin e detit dhe ka nje sip. 22.4 km² nga e cila 6.3 km² janë sipërfaqe urbane.

Ai pozicionohet:

- 125 km larg kryeqytetit të Shqipërisë dhe aeroportit “Nënë Tereza”
- 92 km nga porti i Durrësit
- 85 km nga porti i Vlorës
- 212 km nga porti i Sarandës
- 250 km nga pikat kufitare të Kakavijës dhe Kapshticës.

Ndarja administrative e Bashkisë Berat

Njësitë admin. përbërëse	Sipërfaqja (km ²)	Fshatrat/Qytetet në përbërje të tyre
Berat	19 km ²	Qyteti Berat
Otlak	52.7 km ²	Lapardha1, Lapardha2, Qereshnik, Balibardhë, Dyshnik, Moravë, Ullinjas, Vodëz e sipërme, Orizaj, Otlak.
Velabisht	93.2 km ²	Malinat, Bilçë, Drobonik, Bardhaj i Ri, Starovë, Veterrik, Remanicë, Gjoroven, Palikësht, Veleshnjë, Duhanas, Kodras, Velabisht.
Sinjë	138.5 km ²	Mbolan, Mjeshovë, Mbreshtan, Galinë, Sadovicë, Paftal, Kamçisht, Levan, Velçan, Osmenez 1, Osmenez 2, Plashnik i Vogël, Molisht, Sinjë.
Roshnik	78.7 km ²	Bogdan i Poshtëm, Bogdan i Sipërm, Dardhë, Karkanjoz, Kostren i Madh, Kostren i Vogël, Mimias, Perisnak, Qafë Dardhë, Vojnik, Rabjak, Roshnik Qendër, Roshnik i Vogël.

Berati është qendër ndërkombëtare e trashëgimisë kulturore (lagjet tradicionale të Mangalemit, Goricës dhe Kalasë, Muzeu Kombëtar i Ikonografisë “Onufri” dhe galeritë tjera, muze, kishat, xhamitë).

Historia mbi 2400 vjeçare e bën atë ndër qytetet më të vjetër të vendit tonë. “Qytet Muze” ngaviti 1961 dhe aktualisht pjesë e listës të UNESCO-s si një qytet i Trashëgimisë Kulturore Botërore. Në skajin lindor të territorit të saj, bashkia ka një pjesë të Parkut Kombëtar të Tomorrit (2,416m), ndërsa në perëndim përfshin Malin e Shpiragut (1,218 m).

Sektorët kryesorë mbi të cilët mbështetet ekonomia e Bashkisë Berat janë bujqësia, turizmi, agro përpunimi dhe sektori i shërbimeve.

Njësitë Otlak, Roshnik, Velabisht dhe Sinjë kanë si sektor bazë bujqësinë. Kultivimi i pemëve frutore, ullinjve dhe vreshtarisë është parësor në këto zona.

Në Berat prodhimi i ullirit është në nivele të larta dhe është një nga produktet bujqësore të rëndësishme, ku sipërfaqja e mbjellë me ullinj është 31.9 km².

Berati është zhvilluar si qendër rajonale për agrobiznesin, tregtinë dhe turizmin. Kjo si rrjedhojë e pozicionimit gjeografik, traditës historike, resurseve që mbart në këtë fushë dhe aksesit me rrugët kombëtare.

E rëndësishme të citojmë si tregues mesatar se Qyteti i Beratit ka si sektor kryesor ekonomik shërbimet, 66.9% është raporti i numrit të punësuarve në këtë sektor ndaj numrit të punësuarve gjithsej. Duke u pasuar nga industria me 29% dhe në fund bujqësia me 4.1 %.

Njësitë Otlak, Velabisht, Sinjë dhe Roshnik kanë si sektor kryesor të ekonomisë bujqësinë. Në njësinë Sinjë dhe Roshnik punësimi në bujqësi me rreth vleren 90%.

Krahasimisht për pozicionimin e vëndodhjes së biznesit treguesit statistikor janë :

Biznesi i madh përbën 22 % të totalit të numrit të bizneseve, biznesi i vogël përbën 75 % dhe ai ambulant dhe institucionet 3% të tij.

Numri total i bizneseve është 2325, prej të cilave biznesi i madh 502 dhe biznesi i vogël 1745 biznese, dhe kanë këtë shpërndarje të tyre

Qyteti Berat nga totali prej 2325 biznese ka 1,792 biznese ose 77 % të numrit total. Nga të cilat 80% të biznesit të madh (402 biznese në numër) dhe 75 % të biznesit të vogël (1311 biznese në numër)

Njësia Otlak ka 306 biznese në total ose 13.1 % të totalit, prej të cilave 68 biznese të mëdha dhe 238 biznese të vogla që shprehur në përqindje ndaj totalit të bashkisë janë biznesi i madh

13.5 % dhe 13.6 % biznesi i vogël.

Njësia Velabisht ka 7% të numrit total ose 155 biznese nga të cilat 3% të totalit të biznesit të madh ose 13 biznese dhe 8 % të totalit të biznesit të vogël ose 132 biznese.

Njësia Roshnik ka 1% të numrit total të bizneseve ose 31 biznese nga të cilat 1% të totalit të biznesit të madh ose 3 biznese dhe 2 % të totalit të biznesit të vogël ose 28 biznese.

Njësia Sinjë ka 2% të numrit total të bizneseve ose 41 biznese nga të cilat 3% të totalit të biznesit të madh ose 15 biznese dhe 1 % të totalit të biznesit të vogël ose 26 biznese.

Njohur si në potencial jo më pak ndikim në të ardhurat vëndore Bashkia është përfshirë në njëpunë të plotë projektuese për tregjet me qëllim që të stabilizohen dhe të krijohen kushtet për zhvillim normal të aktivitetit të tyre sidomas për sa ju përket tregjeve sezonal të produkteve bujqësore.

Treguesit demografikë kanë rëndësinë e tyre , të cilët kanë treguar stabilitet në këtë drejtim duke ruajtur një numër popullsie mbi 100 mijë banorë.

Analizuar gjëndjen financiare të bashkisë, e rëndësishme të theksojmë se Bashkia Berat, nuk është Bashki në krizë, dhe viti financiar korent e përmirëson me tej situatën me premis që ne vitin 2023 detyrimet e prapambetura të jone me të vogla se 1%. Kjo si pasoje e harmonizimit e implementimit të projekteve, ka ekonomizuar fondet pa cënuar shërbimet përkundrazi i ka shtuar, përmirësuar ato dhe ka bërë të mundur të shtohet numri i përfituesve të komunitetit për shërbime që kurrë nuk ishin bërë më parë.

Ka përballuar në maksimumin e saj më të mundshëm situatën e krijuar, dhe ecën e sigurt në objektivat e programuara qoftë në objektivat afatshkurtër apo dhe në afatgjatë.

Strategjia e zhvillimit afatgjatë/ strategjia territoriale . **Orientimi afatgjatë i bashkisë (drejtimet kryesore të saj. Burimi i informacionit: PPV/PZHS)**

Vizioni strategjik, që do të udhëheqë zhvillimin e Bashkisë së Beratit gjatë 15 viteve të ardhshme”
"Berati është një qytet i trashëgimisë kulturore botërore, me një strukturë të unifikuar e të konsoliduar,

urbane dhe rurale, me cilësi të lartë jetese, i lidhur mirë me zonat qendrore të Shqipërisë përmes një infrastrukturë moderne, si një destination i fuqishëm turistik dhe portë hyrese/pritëse për një rajon të pasur natyror.

Një nga asetet me me vlerë të Bashkisë Berat janë qytetarët e saj, ndaj rëndësi e veçantë i jepet nxitjes së kualifikimit të kapitalit njerëzor, për të rritur integrimin e të gjithë qytetarëve aktivenë tregun e punës.

Qëllimi kryesor: harmonizimi i zhvillimit ekonomik, infrastrukturor dhe hapësinor me mbrojtjen e burimeve natyrore, zbutjen e pabarazive sociale dhe promovimin e zhvillimit intelektual të shoqërisë përmes parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit.

Misioni i bashkisë në funksion të këtij vizioni zhvillimi është:

Vënia në dispozicion në mënyrë inteligjente e të gjitha burimeve financiare e njerëzore për harmonizimin e interesave publike dhe private, për zhvillim ekonomik e social në të gjithë territorin e Bashkisë Berat.

1.2. Baza ligjore për hartimin e raportit të ekzekutimit të buxhetit

Realizimi i buxhetit të 8-mujorit të vitit 2023 është bërë në përputhje me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64; ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligjin nr. 68 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; nr. 84/2022 "Për Buxhetin e vitit 2023", Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 19.01.2023 të Ministrit të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023", Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 100 datë 22.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025" i ndryshuar.

1.3. Buxheti vjetor dhe Ndryshimet e buxhetit

Për vitin 2023, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është 1,282,484 mijë lekë, i miratuar me VKB nr. 100 datë 22.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025", konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Berat me shkresën nr. 953/1 datë 04.01.2023.

Në këtë VKB është miratuar që : të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2023 kanë vlerën 626,191,197 lekë, transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme ka vlerën 369,887,643 lekë, transfertat e pakushtëzuar sektoriale/specifike (për funksionet e transferuara në v.2016) ka vlerën 286,405,194 lekë.

Në total të ardhurat janë planifikuar në shumën 1,282,484,034 lekë, po ashtu edhe shpenzimet e planifikuara janë 1,282,484,034 lekë.

Në periudhën janar-dhjetor 2023 janë bërë shtesa në buxhetin e vitit 2023 si edhe ndryshime, miratuar me VKB si më poshtë :

- ✓ Me VKB nr. 17 , datë 01.03.2023 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Berat për miratimin e shtesës së buxhetit me fondet e papërdorura dhe të trashëguara nga viti 2022, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 210,563,838 lekë, konkretisht : të ardhurat vendore (kryesisht të ardhurat e muajit 12/22) shuma 110,762 mijë lekë; transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme 5,624 mijë lekë; transfertat e pakushtëzuar sektoriale 94,178 mijë lekë, nga e cila transfertat specifike për mbrojtjen civile 3,461 mijë lekë.

Gjithashtu bashkia Berat trashëgoi nga viti 2022 të ardhura jashtë limitit (sponsorizime) në shumën 2,109,397.73 Lekë të cilat janë me destinacion të përcaktuar në kontratën e sponsorizimit.

Me këtë VKB gjithashtu është marrë vendim nga këshilli bashkiak Berat për rialokim fondesh mes programeve buxhetore dhe kategorive të shpenzimeve.

- ✓ Me VKB nr 16 dt. 19.07.2023 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Berat për shtesë të buxhetit në shumën 8,453,928 lekë. Fondi i është akorduar bashkisë Berat me shkresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 6975/1 datë 27.04.2023 “Transferim fondi për shpenzime kapitale”, për pagesën e TVSH dhe bashkëfinancim projekte me financim të huaj.
- ✓ Me VKB nr 18 dt. 19.07.2023 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Berat për shtesë të buxhetit në shumën 10,702,718 lekë. Fondi i është akorduar bashkisë Berat me shkresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8321 datë 08.05.2023 “Dërgohet rritja e pagave për funksionet e financuara me transfertë sektoriale”, për të mbuluar efektin e rritjes së pagave në zbatim të VKM-ve nr. 240, 241 dhe 242 datë 20.04.2023.
- ✓ Me VKB nr 32 dt. 04.10.2023 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Berat për shtesë të buxhetit në shumën 4,993,810 lekë, me të ardhurat që kthehen nga projektet me financim të huaj, pas validimit të shpenzimeve .
- ✓ Me VKB nr 33 dt. 04.10.2023 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Berat për shtesë të buxhetit në shumën 25,292,738 lekë. Fondi i është transferuar bashkisë Berat nga AZHBR në të ardhurat e Bashkisë për projektin “Krijimi i tregut të gjelbërt Berat për produktet bujqësore fruta-perime”.
- ✓ Me VKB nr 36 dt. 04.10.2023 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Berat për shtesë të buxhetit në shumën 809,998 lekë, me të ardhurat nga projektet.
- ✓ Me VKB nr 47 dt. 30.11.2023 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Berat për shtesë të buxhetit në shumën 1,839,947 lekë. Fondi i është akorduar bashkisë Berat me shkresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 16500/1 datë 09.10.2023 “Transferim fondi për shpenzime kapitale”, për pagesën e TVSH dhe bashkëfinancim projekte me financim të huaj.
- ✓ Me VKB nr 53 dt. 30.11.2023 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Berat për shtesë të buxhetit në shumën 17,533,008 lekë. Fondi i është akorduar bashkisë Berat me shkresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. nr.12674 datë 10.07.2023 “Dërgohet akordimi i fondit për rritjen e pagave në zbatim të Vendimit nr. 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njërive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar , të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njërive të vetëqeverisjes vendore”.
- ✓ Me VKB nr 55 dt. 21.12.2023 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Berat për shtesë të buxhetit në shumën 44,833,000 lekë. Fondi i është akorduar bashkisë Berat me shkresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22656/6 datë 20.12.2023 “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 6 dt. 14.12.2023”, “ Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 84/2022 “Për Buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar.

Buxheti 2023 i Bashkisë Berat pas shtesave dhe ndryshimeve : 1,606,889,662 lekë.

Tabela e ndryshimeve në buxhet paraqitet në vijim:

në mijë lekë

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate vitit		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve					
	Nr/ datë	Vlera	Nr/ datë	Vlera	Pakësuar artik (me emër)/ shtuar artikull					
					(me emër)					
					SHTESA art.	shuma	PAKËSIME art.	shuma		
Viti 2023	VKB Nr. 100, datë 22/12/2022	1,282,484	shkresë nr.882 date 15.02.2023	-	606 (Transferta)	47	600 Paga	(47)		
			shkresë nr.1003 date 21.02.2023	-	606 (Transferta)	60	600 Paga	(60)		
			VKB nr. 17 dt. 01.03.2023 Shtese e buxhetit me te ardhurat e trasheguara nga v.2022	210,564	600 Paga		1,000			
					601 Sigurime		202			
					602 (Shpenzime operative)		59,092			
					604 (Transferime korrente)		-			
					606 (Transferta)		5,712			
230 (shpenzime per kapitale te patrupezuara)		1,145								

		231 Investime	143,413		
VKB nr. 17 dt. 01.03.2023 Rishperndarje e fondeve/shpenzimeve	-	600 Paga	-	600 Paga	(1,120)
		601 Sigurime	-	601 Sigurime	(202)
		602 (Shpenzime operative)	29,368	602 (Shpenzime operative)	(8,180)
		604 (Transferime korrente)	-	604 (Transferime korrente)	-
		606 (Transferita)	2,950	606 (Transferita)	-
		230 (shpenzime per kapitale te patrupezuara)	31,000	230 (shpenzime per kapitale te patrupezuara)	-
		231 Investime	19,000	231 Investime	(72,817)
Shkrese Nr 2121 date 18.04.2023	-	606 (Transferita)	80	600 Paga	(80)
Shkrese Nr.3747 date 14.07.2023	-	606 (Transferita)	284	600 Paga	(284)
VKB nr 16 date 19.07.2023	8,454	231 Investime	8,454		
VKB nr 17 date 19.07.2023		231 Investime	2,320	606 (Transferita)	(2,320)
VKB nr 18 date 19.07.2023, shtese buxheti me transferte sektoriale	10,703	600 Paga	9,177		
		601 Sigurime	1,526		
shkresa nr 4571 date 14.09.2023	-	606 (Transferita)	392	600 Paga	(392)
shkresa nr 4972 date 03.10.2023	-	606 (Transferita)	30	600 Paga	(30)
VKB nr 32 date 04.10.2023	4,994	231 Investime	4,994		
VKB nr 33 date 04.10.2023	25,293	231 Investime	25,293		
VKB nr 36 date 04.10.2023	810	231 Investime	810		
VKB nr 37 date 04.10.2023	-	601 Sigurime	402	600 Paga	(1,154)
		602 (Shpenzime operative)	9,036	231 Investime	(8,284)
Shkrese nr.5339 date 18.10.2023	-	600 Paga	(473)	606 (Transferita)	473
Shkrese nr.5693 date 06.11.2023	-	231 Investime	2,864	600 Paga	(2,864)
VKB nr. 47 date 30.11.2023	1,840	231 Investime	1,840		
VKB nr. 53 date 30.11.2023	17,533	600 Paga	14,347		
		601 Sigurime	3,186		
VKB nr. 55 date 21.12.2023	44,833	602 (Shpenzime operative)	15,077		
		230 (shpenzime per kapitale te patrupezuara)	15,725		
		231 Investime	14,031		

1.4. Çështje të barazisë gjinore

Barazia mes grave dhe burrave përbën një të drejtë themelore për të gjithë. Autoritetet vendore përfaqësojnë nivelet më afër njerëzve, ndaj kemi përgjegjësi të drejtëpërdrejtë që me veprimet dhe politikat tona të nxisim procese që promovojnë një shoqëri të barabartë.

Ne, jemi të vetëdijshëm që përqafimi i konceptit të barazisë është një tregues i spikatur i një qeverisjeje të mirë. Ndaj, sot Bashkia Berat i kushton vëmendje të veçantë nxitjes për barazinë gjinore. Në këtë kuadër, Bashkia Berat ka ndërmarrë disa nisma për të nxitur përfshirjen demokratike dhe të barabartë të burrave dhe grave, djemve dhe vajzave në procese të ndryshme vendimmarrjeje dhe përfaqësuesimi si dhe ka ndjekur politika sociale për përkrahjen e tyre në mënyrë të barabartë. Aty ku ka qenë e mundur, Bashkia Berat ka përcaktuar edhe tregues performance me bazë gjinore, të cilat paraqiten në programet përkatëse buxhetore që shtjellohen në këtë dokument.

2. INFORMACION FINANCIAR

Gjatë procesit të zbatimit të buxhetit të vitit 2023, pas ndryshimeve të bëra me vendimet e marra në Këshillin Bashkiak, Bashkia Berat në fund të periudhës Janar – Dhjetor 2023 rezulton me këtë situatë financiare :

I. TOTALI I FINANCIMEVE (TË HYRAT) në Lekë : 1,386,724,964.38 lekë

në lekë

1. Fonde nga Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme v. 2023.....	432,253,651.00
2. Fonde nga Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale e v.2023.....	307,903,513.00
3. Fonde nga Të ardhurat e vitit (Realizimi i planit të të ardhurave v. 2023)....	436,003,962.23
4. Fonde Të trashëguara nga viti 2022 në vitin 2023	210,563,838.15
• të ardhura lokale	110,762,143.23
• transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme.....	5,623,553.51
• transfertë e pakushtëzuar sektoriale	69,056,981.41
• transferta sektoriale për projekte të veçanta.....	25,121,160.00

TOTALI I FINANCIMEVE (TË HYRAT)..... 1,386,724,964.38

II. TOTALI I SHPENZIMEVE (TË DALAT) në Lekë : 1,191,799,875.48 lekë

në lekë

1. Shpenzimeve korrente total.....	943,236,116.09
a. Shpenzime për personelin (paga dhe sigurime).....	585,536,177.00
b. Shpenzime operative & të mirëmbajtjes dhe të tjera.....	357,699,939.09
2. Shpenzime për investime	248,563,749.39

TOTALI I SHPENZIMEVE Janar – Dhjetor 2023 1,191,799,865.48

III. FONDE TË PAPËRDORURA në fund të vitit 2023 në Lekë : 194,925,098.90

Kapitull	Emërtimi	Trashëguar nga viti 2022	Të ardhura të vitit 2023	Totali i të ardhurave 2022+2023	Përdorimi në vitin 2023	Mbetje trashëgimi për vitin 2024
01	Transferta e Përgjithshme e Pakushtëzuar	5,623,553.51	432,253,651.00	437,877,204.51	411,592,025.53	26,285,178.98
01	Transferta e Përgjithshme Sektoriale	94,178,141.41	307,903,513.00	402,081,654.41	362,336,791.00	39,744,863.41
01	Shuma kap. 1	99,801,694.92	740,157,164.00	839,958,858.92	773,928,816.53	66,030,042.39
05	Të Ardhurat e Veta (pjesa e institucionit)	110,762,143.23	436,003,962.23	546,766,105.46	417,871,048.95	128,895,056.51
	Shuma (kap. 1+5)	210,563,838.15	1,176,161,126.23	1,386,724,964.38	1,191,799,865.48	194,925,098.90
06	Sponsorizime	2,109,397.73	1,827,025.69	3,936,423.42	2,097,310.00	1,839,113.42
	TOTALI (kap. 1+5+6)	212,673,235.88	1,177,988,151.92	1,390,661,387.80	1,193,897,175.48	196,764,212.32

Gjithashtu bashkia Berat trashëgon nga viti 2023 të ardhura jashtë limitit (sponsorizime, kapitull 06) në shumën 1,839,113.42 Lekë, të cilat janë me destinacion për financimin e shpenzimeve të përcaktuara në kontratën e sponsorizimit. Këto fonde detajohen dhe përdoren vetëm në destinacionin përkatës .

Lista e projekteve të sponsorizuara :

Sponsorizime (Ilog. 7207011)	Trasheg nga viti 2022	Derdhur/shtesa ne vitin 2023	Shuma Totale	Perdorur ne vitin 2023	Mbeten per t'u trasheg. ne v. 2024
Alpha Bank, sponsorizim per rikonstrukcionin e Shatervanit	205,000.00		205,000.00		205,000.00
Erasmus +	503.42		503.42		503.42
Sponsorizim FLAG Projekti "Siguria publike ne nivel vendor"	562,000.00		562,000.00		562,000.00
Ambasada Japoneze "Per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimi"	177,500.00		177,500.00	177,500.00	0.00
Save the Children, "Kend sportiv dhe rekreativ ne shkollen Velabisht, Berat"	583,330.00		583,330.00	550,460.00	32,870.00
Ambasada gjermane, "Ndertimi i kendit te lojerve ne parkun Deshmoret e Kombit"	581,064.31	357,935.69	939,000.00	939,000.00	0.00
PNUD , "Askush te mos mbetet si ju"		1,469,090.00	1,469,090.00	430,350.00	1,038,740.00
Shuma Sponsorizime	2,109,397.73	1,827,025.69	3,936,423.42	2,097,310.00	1,839,113.42

PASQYRË PËRMBLEDHËSE E REALIZIMIT TË BUXHETIT Janar – Dhjetor 2023

në lekë

Nr.	Pershkrimi	Buxheti 2023 fillestar	Shtesa ne buxhet	Buxheti 2023 pas shtesave e ndryshimeve	Struktura	Fakt	Realizimi i planit vjetor
		(miratuar ne m. 12/22)			%	2023	ne %
I	Totali i te ardhurave	1,282,484,034	324,405,628	1,606,889,662	100%	1,386,223,238	86.3%
1	Total Transferta	656,292,837	183,164,296	839,457,133	52%	839,457,133	100.0%
a	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	369,887,643	62,366,008	432,253,651	27%	432,253,651	100.0%
b	Transf. e pakushtëzuar trashëguar nga viti paraardhes	0	5,623,554	5,623,554	0%	5,623,554	100.0%
c	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	286,405,194	20,996,593	307,401,787	19%	307,401,787	100.0%
d	Transferta e pakushtëzuar sektoriale e trashëguar nga viti parardhes	0	94,178,141	94,178,141	6%	94,178,141	100.0%
2	Total te ardhura te veta	626,191,197	141,241,332	767,432,529	47.8%	546,766,105	71.2%
a	Te ardhura te veta	626,191,197	30,479,189	656,670,386	41%	436,003,962	66.4%
b	Te ardhura te veta trashëguar nga viti paraardhes	0	110,762,143	110,762,143	7%	110,762,143	100.0%
II	Totali i Shpenzimeve	1,282,484,034	324,405,628	1,606,889,662	100%	1,191,799,865	74.2%
1	Totali shpenzime operative (korrente)	1,025,112,034	138,099,408	1,163,211,442	72%	943,236,116	81.1%
a	Shpenzime personeli	610,121,034	24,444,830	634,565,864	39%	585,536,177	92.3%
b	Shp.operative & mirembajtje & te tjera transferta	414,991,000	113,654,578	528,645,578	33%	357,699,939	67.7%
2	Shpenzime kapitale	257,372,000	186,306,220	443,678,220	28%	248,563,749	56.0%

Siç shihet nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme, në periudhën Janar – Dhjetor 2023 :

Të ardhurat janë realizuar në total në shumën **1,386,223,238** ose në masën **86.3% e planit vjetor** 1,606,889,662 lekë.

Të ardhurat e realizuara sipas burimit :

- të ardhurat e veta 436,003,962 lekë ose në masën 66.4 % e planit vjetor prej 656,670,386 lekë.
- të ardhurat nga transfertat 739,655,438 lekë ose në masën 100% të planit vjetor.
- të ardhurat e trashëguara nga v. 2022 (të ardhura të veta&transfertat) 210,563,838 lekë.

Shpenzimet janë realizuar në total në shumën **1,191,799,865 lekë** ose në masën **74.2 % e planit vjetor** prej 1,606,889,662 mijë lekë.

Shpenzimet e realizuara sipas natyrës :

- shpenzime personeli realizuar në masën 92.3 %, realizim në shumën 585,536,177 lekë kundrejt planit vjetor 634,565,864 lekë.
- shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes realizuar në masën 67.7 %, shuma 357,699,939 lekë kundrejt planit vjetor 528,645,578 lekë.
- shpenzimet kapitale realizuar në masën 56 %, shuma 248,563,749 lekë kundrejt planit vjetor 443,678,220 lekë.

Gjendja e fondeve të papërdorura në fund të periudhës Janar – Dhjetor 2023 është **194,925,099 lekë**.

2.1. REALIZIMI I TË ARDHURAVE

Analiza e realizimit të të ardhurave:

Të ardhurat e bashkisë përbëhen nga:

- Të ardhurat nga transfertat e qeverisë qendrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme, transfertat e pakushtëzuar sektoriale (për funksionet e transferuara ne v.2016) dhe transfertat e kushtëzuar. Të ardhurat nga transfertat zënë mesatarisht 51% të planit vjetor të të ardhurave të përgjithshme të bashkisë.
- Të ardhurat nga burimet e veta vendore ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifatat vendore dhe të ardhura të tjera të bashkisë, përfshirë edhe trashëgiminë nga viti 2022. Të ardhurat e veta zënë mesatarisht 49 % të planit vjetor të të ardhurave të përgjithshme të bashkisë.

TOTALI I BURIMEVE TË FINANCIMIT

Tabelat më poshtë paraqesin të ardhurat sipas planifikimit dhe realizimit 2023

Burimet e financimit të buxhetit të pavarur

në lek

Buxheti i Pavarur	2021	2022	2023	2023	2023	Realizimi
	Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	ndryshuar	Fakt	ne %
A Të Ardhura nga Burimet e Veta	412,235,047	454,534,097	626,191,197	656,670,386	436,003,962	66.4%
Të Ardhura nga Taksat Lokale	138,588,546	161,718,280	182,800,015	182,800,015	131,987,466	72.2%
Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	53,947,722	56,728,620	41,308,992	41,308,992	64,311,129	155.7%
Të Ardhurat nga Tarifatat Vendore	173,181,667	188,804,679	246,417,056	246,417,144	189,213,127	76.8%
Të Ardhurat e Tjera	46,517,112	47,282,518	155,665,134	186,144,235	50,492,241	27.1%
B Transferta nga Buxheti Qendror	590,617,575	637,218,894	656,292,837	739,655,438	739,655,438	100.0%
Transferta e Pakushtëzuar	298,960,088	334,516,738	369,887,643	432,253,651	432,253,651	100.0%
Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	291,657,487	302,702,156	286,405,194	307,401,787	307,401,787	100.0%
C Trashëgimi nga Viti i Shkuar	120,818,810	134,198,800	-	210,563,838	210,563,838	100.0%
Trashëgimi Pa Destinacion	120,818,810	134,198,800	-	210,563,838	210,563,838	100.0%
TOTALI I TË ARDHURAVE TË B.	1,123,671,432	1,225,951,791	1,282,484,034	1,606,889,662	1,386,223,238	86.3%

Burimet e financimit të buxhetit total duke përfshirë edhe transfertën e kushtëzuar

në lek

BURIMET BUXHETORE		2021	2022	2023	2023	2023	Realizimi
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Buxheti i ndryshuar	Fakt	ne %
A	Të Ardhura nga Burimet e Veta	412,235,047	454,534,097	626,191,197	656,670,386	436,003,962	66.4%
A.1	Të Ardhura nga Taksat Lokale	138,588,546	161,718,280	182,800,015	182,800,015	131,987,466	72.2%
A.2	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	53,947,722	56,728,620	41,308,992	41,308,992	64,311,129	155.7%
A.3	Të Ardhurat nga Tarifat Vendore	173,181,667	188,804,679	246,417,056	246,417,144	189,213,127	76.8%
A.4	Të Ardhurat e Tjera	46,517,112	47,282,518	155,665,134	186,144,235	50,492,241	27.1%
B	Transferta nga Buxheti Qendror	1,339,237,931	1,378,988,951	656,292,837	1,632,912,561	1,632,912,561	100.0%
B.1	Transferta e Pakushtëzuar	298,960,088	334,516,738	369,887,643	432,253,651	432,253,651	100.0%
B.2	Transferta e Kushtëzuar	748,620,356	741,770,057	-	893,257,123	893,257,123	100.0%
B.2.1	Për funksionet e deleguara	447,580,715	488,116,375		465,503,838	465,503,838	100.0%
B.2.2	Për projekte të veçanta (FZHR dhe të tjera)	301,039,641	253,653,682		427,753,285	427,753,285	100.0%
B.3	Trasferta e Pakushtëzuar Sektoriale	291,657,487	302,702,156	286,405,194	307,401,787	307,401,787	100.0%
C	Huamarrja	-	-	-	-	-	
C.1	Huamarrja Afatshkurtër	-	-	-	-	-	
C.2	Huamarrja Afatgjatë	-	-	-	-	-	
D	Trashëgimi nga Viti i Shkuar	123,204,259	144,843,123	-	212,673,236	212,673,236	100.0%
D.1	Trashëgimi Pa Destinacion	120,818,810	134,198,800		210,563,838	210,563,838	100.0%
D.2	Trashëgimi Me Destinacion	2,385,449	10,644,323		2,109,398	2,109,398	100.0%
	TOTALI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË	1,874,677,237	1,978,366,171	1,282,484,034	2,502,256,183	2,281,589,759	91.2%

TË ARDHURAT VENDORE

Plani i të ardhurave dhe indikatorët që shprehin nivelin e realizimit të tij në periudha të ndryshme kohe si pjesë e planit të veprimit për realizimin e buxhetit, në kohë dhe periodikisht përbën një proces të pa ndërprerë. Si i tillë dhe ky moment në të cilin ndalemi dhe monitorojmë për të gjithë zërat analitikisht dhe në mënyrë të grupuar merr një rëndësi të vecantë pasi:

- Jemi në tremujorin e katërt, periudhë kjo gjatë së cilës draftojmë plan buxhetin e vitit 2024 dhe PBA 2024-2027. Një proces ky shumë i rëndësishëm sidomos për planin e të ardhurave.
- Mat konkretisht gjithë treguesit dhe shërben për të bërë ndërhyrjet e domosdoshme në organizimin dhe administrimin e pritshëm të planit në total dhe në afat gjatë në PBA 2024-2027.

Në mënyrë të drejtëpërdrejtë si pjesë e rëndësishme e proceseve administruese dhe zbatuese në Bashki monitorimi ka specifik se mat dhe krahason indikatorë real dalë nga të dhënat e realizuar dhe bën krahasueshmeri të detajuar për të gjithë zërat pjesë e tij.

Pasqyrimi sipas zërave, sipas drejtorive dhe Bashkia si një e tërë, bën të mundur që secila pjesë e administratës së bashkisë të bëjë analizat e veta në shërbim të përmbushjes së objektivave të planifikuar, dhe ndërkohë të korrigjojë aty ku është e nevojshme në funksion të shfrytëzimit të mundësive dhe hapësirave që ka sjellë periudha që analizojmë dhe përditësimet e ndodhura.

Ndonëse nuk ndryshon motoja bazë mbi të cilën ne udhëhiqemi në hartimin e planit të të ardhurave – “Biznesi si partner”, nuk ndryshon as metodologjia bazë që udhëhiqemi në këtë moto, lehtësisht dallojmë se :

- Biznesi në administratën e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave ka gjetur realisht një korrektesë maksimale për t’iu përgjigjur në kohë dhe me bazueshmeri të plotë ligjore.
- Një komunikim në vijimësi dhe tejet i mirë organizuar ka sjellë dhe një qëndrueshmëri në realizimin e të ardhurave nga biznesi krahasimisht me vitet e mparshme. Biznesi gjen në administratë një transparence maksimale dhe ligjërisht të bazuar.
- Në këtë periudhë që monitorojmë për realizimin e treguesve të të ardhurave, vizitat fiskale, këshilluese e monitoruese në biznes jo vetëm që kanë qënë më të shumta por dhe cilësisht të mirë organizuara pa fushata dhe në funksion të parimit- Të barabartë përpara ligjit çdo NUIS çdo biznes, çdo familje, çdo ojf e jo vetëm por dhe çdo institucion buxhetor. Kjo ka sjellë për rrjedhim atë qëndrueshmëri që cilësuam dhe në shprehjen tonë në paragrafët me sipër.
- Edhe pse kemi një paketë fiskale të mirë strukturuar dhe shumë të plotë e të qartë e të kuptueshme për çdo përdorues të saj, ne kemi në vëmendjen tonë përditësimin dhe përmirësimin e saj mbështetur dhe në vendimmarrjet e Këshillit Bashkiak.
- Çdo tarifë, çdo taksë e përcaktuar në paketën fiskale pavarësisht peshës së saj në totalin e të ardhurave ka vëmendjen tonë për ta realizuar dhe pse jo për të gjeneruar të ardhura në funksion të planit total.(Citojmë këtu të ardhurat nga Drejtoria e Bujqësisë me kontratat me familjarë për dru zjarri)

Promocioni i produkteve dhe shërbimeve gjithë vjetor në mbështetje të biznesit.

- Organizimi i festave, panairëve, dhe aktiviteteve promovuese kanë rritur besueshmërinë e biznesit si partnerë. Festa e Fikut, qershisë, festivali i verës, festa e miqësisë, apo koncertet e ndryshme në zonën e pedonale.
- Rritja e numri të biznesve në projektin e “start up” karhas rritjes së numrit të biznesve fituese e të financuar nga projekti “Help”.
- Organizimi i eventeve në qendrat e njësive administrative, si dhe në qendrën e qytetit një risi e konsoliduar në funksion të gjallërimit të jetës dhe në ndihmë të promocionit të produkteve nga biznesit.
- Festat nuk janë më vetëm protokollare por një mundësi më shumë për promovimin e vlerave dhe produkteve
- Hapësira mediatike dhe në rrjetet sociale duke u bërë jehonë arritjeve të biznesit.
- Shtirirja e investimeve në të gjithë territorin e bashkisë.
- ✓ Investimet kapitale në Bashki kanë marrë tashmë një shtirirje në të gjithë territorin dhe njësitë, filluar nga Roshniku, Velabishti me rrugën Velabisht- Remanicë, Ura e Gjorovenit, apo dhe ajo e Bilcës janë realitetet të përfunduara apo nisura por dhe në sport e kulturë .
- ✓ Mirëmbajtja e rrugëve rurale si dhe pastrimi i kanaleve kulluese për vaditje janë mundësi më shumë për të siguruar qëndrueshmëri në prodhime të zonës por dhe ruajtjen e numrit të bizneseve në njësi. Restorantet agro turizëm që u shërbejnë komunitetit dhe turistëve të shumëfishuar në numër, një premisë pozitive në rritje që e shpreh se rritja dhe shpërndarja e investimeve e sheh Bashkinë si një të tërë.


Jo vetëm fluksi i turistëve por dhe rritje e investimeve dhe mirëmbajtja e banesave në zonën muzeale janë tregues i rëndësishëm për të nënvizuar se Berati ndryshon çdo ditë ekonomia e tij po siguron performancë pozitive të qëndrueshme në rritje.

Viti 2023, një vit financiar që ruan e përmirëson gjithnjë e më shumë kolonat bazë për të siguruar trend rritës jo vetëm të investimeve por dhe të ardhurave nga të cilat mbështeten këto investime.

Referuar indikatorëve dhe krahasueshmërisë me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar apo dhe kundrejt planit të periudhës të cilën monitorojmë kemi të dhënat e pasqyruara në materilain në vijim.

Të ardhurat vendore të planifikuara për vitin 2023, si dhe realizimi i tyre referuar të dhënave përfundimtare të rakorduara nga dega e thesarit janë në këto tregues:

Nr	Emertimi	Plani 2023	Fakti 2023	Realizimi ne % 2023
I	Agjentet Tatimore	46,509	65,651	141%
II	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave	356,088	257,250	72%
III	Drejtoria E Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve	41,129	9,228	22%
IV	Drejtoria E Planifikimit Urban, Lejeve Dhe Monitorimit Të Investimeve	80,000	47,352	59%
V	Drejtoria Bujqsise,Administrimit te Pyjeve,Ujerave dhe Sherbimit Veterinar	68,547	5,335	8%
VI	Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimit	20,010	12,774	64%
VII	Tarifa te Pallatit te Kultures dhe Bibliotekes	24	-	0%
VIII	Te ardhura nga MZSH	324	1,280	395%
IX	Te tjere debitore (gjyqe dhe klsh)	3,000	4,125	137%
X	Agjencia e sherbime publike	9,526	7,111	75%
XI	Te ardhura te priteshme nga bashkefinancimet e huaja	1,033	604	58%
TOTALI		626,191	410,711	66%



Pasqyra e mësipërme shpreh në vlerë dhe në indeks për secilin grup nivelin e realizimit të planit dhe realizimin e tij në total.


Analitikisht faktorët ndikues bazë në këtë tregues, i trajtojmë sipas përparësisë në paragrafet e mëposhtëm, mbështetur në një analizë të plotë sipas ndikimit të çdo faktori.

Në qytetin e Beratit për vitin 2023 kanë ushtruar aktivitetin ekonomik 2300 subjekte biznesi, 40 Institucione.

Ndarja e bizneseve sipas kategorive dhe njësive administrative:


1. Subjekte të biznesit të vogël

	BERAT	OTLLAK	VELABISHT	ROSHNIK	SINJE	Total
SHUMA TOTAL	1,353	230	138	27	22	1,770
Restorant, ushqim i shpejtë, piceri	45	14	4	5	7	75
Prodhim	77	16	17	1	3	114
Shitje me pakicë	442	98	52	8	5	605
Bar - Kafe	174	29	26	3		232
Ushqimore	86	10	9		2	107
Profesione të lira	135	3	2		0	140
Shërbime	272	2	15	1		290
Transport	95	47	12	9	2	165
AMBULANT	27	11	1		3	42




2. Subjekte të biznesit të madh

	BERAT	OTLLAK	VELABISHT	ROSHNIK	SINJE	Total
TOTALI	441	66	10	3	10	530
Transport	69					69
Import eksport	248	52	7		6	313
Prodhim	63	10	3	3	4	83
Ndertim	24	4		0		28
OJF	19	0		0	0	19
Banka	18	0		0	0	18




3. Institucione shtetërore

Institucione (Numri)	40
Institucionet, Me numër të punësuarish ≤ 5 vetë	4
Institucionet, Me numër të punësuarish 5 deri 20 vetë	16
Institucionet, Me numër të punësuarish ≥ 20 vetë	20



SUBJEKTET	TOTAL	Në %
SUBJEKTE TË BIZNESIT TË MADH	1,770	77%
Restorant, ushqim i shpejtë, piceri	75	3%
Prodhim	114	5%
Shitje me pakicë	605	26%
Bar - Kafe	232	10%
Ushqimore	107	5%
Profesione të lira	140	6%

Shërbime	290	13%
Transport	165	7%
AMBULANT	42	2%
SUBJEKTE TË BIZNESIT TË VOGËL	530	23%
Transport	69	3%
Import eksport	313	14%
Prodhim	83	4%
Ndertim	28	1%
OJF	19	1%
Banka	18	1%
TOTAL	2,300	100%



- Analiza e realizimit të planit të të ardhurave.

Planifikimi fillestar në plan buxhetin e vitit 2023 ishte gjithsej 626,191,000 lekë të ardhura nga taksat dhe tarifatat vendore të Bashkisë Berat përfshirë dhe njësitë administrative Roshnik, Sinjë, Velabisht dhe Otlak, dhe institucioneve të vartësisë përfshirë dhe agjentët tatimor.

Viti 2023 është një vit gjatë të cilit bizneset vijuan të konsolidojnë ndryshimet strukturore që nisën gjatë dhe pas situatës pandemike. Për rrjedhim krahasimisht me vitin 2021, indeksi i strukturës sipas llojit dhe sipas aktivitetit ka ndryshime mjaftueshëm të vogla por hoteleri turizëm dhe me theks aktivitetet me drejtim turistik kanë një rritje më të lartë.

Nga ana sasiore, shprehur në numër total të biznesit ka një qendrueshmëri dhe kjo materializon që ekonomia e qytetit ka një zhvillim të qendrueshëm. Për rrjedhim edhe qendrueshmëria financiare e Bashkisë ka një nivel që krijon premisa për objektiva më të mëdha.

Referuar trendit të përgjithshëm dallueshëm konstatohet një tred në qendrueshmëri por edhe me luhatje kundrejt detyrës së planifikuar.

Kjo edhe për arsye të uljes së numrit të familjeve rezidente, kundrejt detyrës së planifikuar.

Gjithashtu edhe pse investimet në infrastrukturë në qytet janë rritur ndjeshëm, sektori privat në vitin 2023 ka një rënie përtej pritshmërive dhe treguesve në plan. Fakti që këto investime janë në procedura të plotësimit të dokumentacionit shton premisat për një pritshmeri pozitive në vijim edhe pse në faktin 2023 rezulton me realizim të ulët. Nuk mund të mos konstatohet se ngritja e funksionimi i strukturës së borxhit ka sjellë ndikimin e vetë

pozitiv.


-Niveli i arkëtimeve sidomos nga biznesi në nivelin e 94 % të detyrës së planifikuar shpreh luftën pa kompromis të zhvilluar ndaj evazionit fiskal edhe pse të tjera sfida na presin gjatë vitit 2023.

Për rrjedhim realizimi i të ardhurave të planifikuara kundrejt objektivave ishte në vlerën e 410,711,000 lekë.

Krahasimisht me tre vitet

Në 000/lekë

Viti	2020	2021	2022	2023
Fakt	333,588	402,418	454,534	410,711



Të ardhurat nga agjentët tatimorë

Në 000/lekë

Nr	Emertimi	Plani Vjetor	Fakti 12 Mujor	Realizimi ne %
I	Agjentet Tatimore	46,509	65,651	141%
1	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel	5,200	1,340	26%
2	Te ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	8,000	24,910	311%
3	Takse e kalimiti te drejtes se pronsise (ZRPP)	3,090	1,917	62%
4	Takse e mjeteve te perdorura	30,179	37,305	124%
5	Taksa e rentës minerare	40	179	448%

Të ardhurat nga taksat vendore

Përgjithësisht zërat e taksave vendore kanë pasur një realizim 88% të vlerës së planifikuar, ku vlen të përmendim:

Në 000/lekë

Nr	Emertimi	Plani Vjetor	Fakti 12 Mujor	Realizimi ne %
1	Takse tabele	2,529	2,207	87%
	Tabelë për qëllime identifikimi	1,948	1,723	88%
	Tabelë për qëllime reklamimi	582	484	83%
2	Te ardhura nga zenia e hapsirave publike	16,364	15,237	93%

3	Takse fjetje ne hotel	6,004	6,308	105%
4	Takse mbi token bujqesore	18,555	14,157	76%
5	Takse mbi ndërtesat	51,912	45,040	87%
	Biznes	24,806	21,838	88%
	Familje	27,106	23,202	86%
6	Takse trualli	7,482	7,043	94%
	Biznes	6,338	6,299	99%
	Familje	1,144	743	65%
	TOTALI	102,846	89,992	88%

Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë, taksa mbi ndërtesat, mbi truallin, Taksa e tabelës, Taksë fjetje në hotel, të ardhurat nga zënies së hapësirave publike, taksa mbi tokën bujqësore, taksa e mjeteve të përdorura, taksa mbi trualli.

1. Taksa mbi ndërtesat, është realizuar 45,040,000 lekë ose 87 % kundrejt planit vjetor.
2. Taksa mbi tabelat, është realizuar 2,207,000 leke ose 87% kundrejt planit vjetor.
3. Taksa mbi truallin, është realizuar 7,043,000 leke ose 94% kundrejt planit vjetor.
4. Taksa mbi tokën bujqësore, është realizuar 14,157,000 lekë ose 76% kundrejt planit vjetor.
5. Të ardhura nga zënia e hapësirave publike (tregu industrial, dhe hapësira të tjera), është realizuar 15,237,000 lekë ose 93% kundrejt planit vjetor.

Të ardhurat nga tarifat vendore

Kryesisht këto tarifa mblidhen nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, nga Njësitë administrative dhe agjenti tatimor Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat sh.a dhe Drejtoritë e tjera që gjenerojnë të ardhura

Realizimi i këtyre zërave, për vitin 2023 ishte në masën 71% kundrejt planit fillestar.

Në 000/lekë

Nr	Emertimi	Plani Vjetor	Fakti 12 Mujor	Realizimi ne %
1	Tarife e pastrimit	104,777	83,662	80%
	Biznes	57,389	54,802	95%
	Familje	47,389	28,860	61%
2	Tarife e ndriçimit publik	47,683	36,590	77%
	Biznes	18,738	17,758	95%
	Familje	28,945	18,832	65%
3	Tarife gjelberimi publik	40,250	31,087	77%
	Biznes	12,864	12,236	95%
	Familje	27,386	18,851	69%
4	Tarife Arsimi publik	11,135	8,565	77%
	Biznes	4,539	4,444	98%
	Familje	6,597	4,121	62%
5	Te tjera tarifa(Ambjenti)	1,021	840	82%
6	Tarife per linjat ajerore nentokesore (Kablloret)	780	682	87%
7	Te ardhura nga parkimi	4,332	2,515	58%
8	Tarife per license /certifikate per transport rrugor	5,273	1,388	26%

9	Tarife urbanistike	80,000	47,352	59%
10	Tarife per lende drusore	2,411	1,363	57%
11	Tarife ujitje	3,150	1,769	56%
12	Te ardhura nga konviktet	2,896	3,041	105%
13	Te ardhurat per regjistrim	861	400	46%
14	Te ardhura nga kopshtet dhe cerdhet	16,253	9,334	57%
15	Tarfia per zenie salle dhe dheniie ambjentesh me qera	24	-	0%
16	Tarifa e sherbimit te varrimit	9,526	7,111	75%
	TOTAL	330,373	235,697	71%

Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë tarifatat vendore të pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit që mblihen nga biznesi dhe nga familjet.

1. Tarifë Pastrimi, është realizuar 83,662,000 lekë ose 80% kundrejt planit vjetor
2. Tarifë Ndricimi është realizuar 36,590,000 lekë ose 77% kundrejt planit vjetor
3. Tarifë Gjelbërimi është realizuar 31,087,000 lekë ose 77% kundrejt planit vjetor
4. Tarife urbanistik 47,352,000 lekë ose 59% kundrejt planit vjetor.

Të ardhurat nga tarifatat vendore paraqesin nivel 71%, por prapë puna vazhdon për të arritur treguesit e planifikuar.

Përveç realizimit në nivel të mirë të tarifave mbi biznesin, efekt në realizimin e të ardhurave nga tarifatat vendore ka edhe realizimi i të ardhurave nga tarifatat e familjes dhe kjo si rezultat i faturimit të këtyre tarifave së bashku me faturën e ujit të pijshëm si pasojë e kontratave të reja të lidhura.

Realizim shumë të mirë kanë edhe të ardhurat nga tarifatat e institucioneve shtetërore.(Gjithësej 40 institucione).

Në mënyrë analitike pasqyra e më poshtme për të gjithë zërat e të ardhurave:

PASQYRA E REALIZIMIT TE PLANIT TE TE ARDHURAVE PER VITIN 2023

Në 000/lekë

Nr	Emertimi	Plani Vjetor	Fakti 12 Mujor	Realizimi ne %
I	Agjentet Tatimore	46,509	65,651	141%
1	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel	5,200	1,340	26%
2	Te ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	8,000	24,910	311%
3	Takse e kalimiti te drejtes se pronsise (ZRPP)	3,090	1,917	62%
4	Takse e mjeteve te perdorura	30,179	37,305	124%
5	Taksa e rentës minerare	40	179	448%
II	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave	356,088	257,250	72%
1	Takse table	2,529	2,207	87%
	Tabelë për qëllime identifikimi	1,948	1,723	88%
	Tabelë për qëllime reklamimi	582	484	83%
2	Te ardhura nga zenia e hapsirave publike	16,364	15,237	93%
3	Takse fjetje ne hotel	6,004	6,308	105%
4	Takse mbi token bujqesore	18,555	14,157	76%
5	Takse mbi ndertesat	51,912	45,040	87%
	Biznes	24,806	21,838	88%
	Familje	27,106	23,202	86%
6	Takse trualli	7,482	7,043	94%
	Biznes	6,338	6,299	99%
	Familje	1,144	743	65%
7	Tarife e pastrimit	104,777	83,662	80%

	Biznes	57,389	54,802	95%
	Familje	47,389	28,860	61%
8	Tarife e ndriçimit publik	47,683	36,590	77%
	Biznes	18,738	17,758	95%
	Familje	28,945	18,832	65%
9	Tarife gjelberimi publik	40,250	31,087	77%
	Biznes	12,864	12,236	95%
	Familje	27,386	18,851	69%
10	Tarife Arsimit publik	11,135	8,565	77%
	Biznes	4,539	4,444	98%
	Familje	6,597	4,121	62%
11	Te tjera tarifa(Ambjenti)	1,021	840	82%
12	Tarife per linjat ajrore nentokesore (Kablloret)	780	682	87%
13	Te ardhura nga parkimi	4,332	2,515	58%
14	Debitore Familje	19,433	1,595	8%
15	Debitore Biznesi	23,831	1,724	7%
III	Drejtoria E Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve	41,129	9,228	22%
1	Tarife per license /certifikate per transport rrugor	5,273	1,388	26%
2	Te ardhura nga qerate	30,778	7,840	25%
3	Debitore	5,079	-	0%
IV	Drejtoria E Planifikimit Urban, Lejeve Dhe Monitorimit Të Investimeve	80,000	47,352	59%
1	Tarife urbanistike	18	25	141%
2	Taksa e Ndikimit ne infstrukture nga ndertimet e reja	79,982	47,327	59%
V	Drejtoria Bujqsise,Administrimit te Pyjeve,Ujerave dhe Sherbimit Veterinar	68,547	5,335	8%
1	Tarife per lende drusore	2,411	1,363	57%
2	Tarife ujitje	3,150	1,769	56%
3	Te tjera te ardhura nga pronesia	62,986	2,203	3%
VI	Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimit	20,010	12,774	64%
1	Te ardhura nga konviktet	2,896	3,041	105%
2	Te ardhurat per regjistrim	861	400	46%
3	Te ardhura nga kopshtet dhe cerdhet	16,253	9,334	57%
VII	Tarifa te Pallatit te Kultures dhe Bibliotekes	24	-	0%
1	Tarfia per zenie salle dhe dhenie ambjentesh me qera	24	-	0%
VIII	Te ardhura nga MZSH	324	1,280	395%
IX	Te ardhura te priteshme nga bashkefinancimet e huaja	1,033	604	58%
X	Te tjere debitore (gjyqe dhe klsh)	3,000	4,125	137%
XI	Agjencia e sherbime publike	9,526	7,111	75%
1	Tarifa e sherbimit te varrimit	9,526	7,111	75%
TOTALI		626,191	410,711	66%

Realizimi i të ardhurave sipas Njësive Administrative:

Krahasimi me detyrën e planifikuar konstatohet një rënie dhe nga analiza e bërë për detyrat e planifikuara konstatohet këta faktor me ndikim në nivelin e realizimit:

- Ulje e numrit të familjeve rezidente krahasimisht me numrin e parashikuar në plan.
- Rritje të debisë vjetore për familjarët dhe për këtë arsye kemi përdorur dhe bllokimin e llogarive bankare të tyre si masë shtrenguese.
- Ndikimi i vitit elektoral.
- Ulja e vëmendjes kundrejt kësaj detyre nga Kryetarët e njësive Administrative të cilët referuar legjislacionit e kanë për detyrë ti monitorojnë dhe ndikojnë në arkëtimin e tyre.

Analiza e nivelit të realizimit të planit të të ardhurave që ne kemi bërë në çdo njësi për të ardhurat

konkludon se objektivat tanë për këtë burim (referuar të ardhurave sipas njësive), qëndrojnë të larta dhe të realizueshme për periudhën 2024 e në vijim. Kjo jo vetëm si rezultat i rritjes së masave shtrënguese por dhe si rezultat i rritjes së përgjegjshmërisë të gjithë personelit administrativ që mbulon këtë fushë.

Në përfundim gjithashtu konstatohen edhe disa indikatorë të rëndësishëm që premtojnë në plotësimin e detyrave në periudhën në vijim, ndër të cilët nënvizojmë:

- Biznesi beratas ka rritur vëmendjen dhe ndryshuar strukturën e vet kryesisht duke u fokusuar në shërbime, eksport import dhe në turizëm.
- Rritja e kontratave me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sh.a ka ndikuar ndjeshëm në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore nga familjet.

TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR

Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga burimet e veta, janë burimi kryesor i buxhetit të bashkisë. Bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Për vitin 2023, Bashkisë Berat i është akorduar fillimisht transferta e pakushtëzuar e përgjithshme 369,887,643 lekë; në krahasim me vitin 2022 transferta është parashikuar me rritje me 61,608 mijë lekë ose në masën 20 %.

Gjatë vitit 2023, është akorduar shtesë transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme 62,366,008 lekë për:

- 17,533,008 lekë, fond i akorduar me shkresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. nr.12674 datë 10.07.2023 “Dërgohet akordimi i fondit për rritjen e pagave në zbatim të Vendimit nr. 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësisve të vetëqeverisjes vendore”.
- 44,833,000 lekë, fond i akorduar me shkresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22656/6 datë 20.12.2023 “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 6 dt. 14.12.2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 84/2022 “Për Buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar.

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme e trashëguar nga viti 2022 është 5,623,553.51 lekë.

Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Transferta e pakushtëzuar sektoriale përdoret për të financuar funksionet e transferuara si më poshtë:

Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar.

Në transfertën e pakushtëzuar sektoriale të vitit 2023, janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar.

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MNZSH)

Në transfertën e pakushtëzuar të vitit 2023, janë fondet për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit. Në këto fonde bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Rrugët rurale

Në transfertën e pakushtëzuar sektoriale të vitit 2023, janë alokuar fondet për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki.

Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Në transfertën e pakushtëzuar sektoriale të vitit 2023, janë planifikuar fondet për Shërbimin Pyjor dhe kullosor. Në këtë fond përfshiheshin fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Ujitja dhe Kullimi

Në transfertën e pakushtëzuar sektoriale të vitit 2023, janë planifikuar fondet për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond përfshiheshin fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Arsimi i mesëm i përgjithshëm

Në transfertën e pakushtëzuar sektoriale të vitit 2023, janë akorduar fonde për arsimin e mesëm të përgjithshëm. Në këtë transfertë janë te përfshira: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator) dhe shpenzimet operative.

Qendrat e Shërbimeve Sociale

Në transfertën e pakushtëzuar sektoriale të vitit 2023 janë akorduar fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit dhe shpenzime operative të Qendrës Rezidenciale “Lira”

Niveli i transfertës së pakushtëzuar sektoriale

në 000 lekë

Nr	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	2020	2021	2022	2023
1	Konviktet e arsimit parauniversitar	27,374	27,374	27,665	28,495
2	Arsimi parashkollor	134,503	136,006	149,491	156,251
3	Arsimi parauniversitar	13,579	13,987	14,546	15,060
4	Mbrojtja nga zjarri	30,550	31,466	32,725	34,313
5	Mbrojtja sociale (Qendra “LIRA”)	23,731	23,731	23,984	24,703
6	Administrimi i pyjeve	5,151	5,666	5,893	6,103
7	Rrugët	4,824	4,824	5,228	5,374
8	Ujitja dhe Kullimi	14,250	15,095	15,699	16,106
	Total	253,962	258,148	275,231	286,405

Për vitin 2023 , Bashkisë Berat i është akorduar fillimisht transferta e pakushtëzuar sektoriale 286,405,194 lekë.

Gjatë vitit 2023 , është akorduar shtesë transfertë sektoriale /specifike 21,498,319 lekë për :

- 8,453,928 lekë akorduar me shkresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 6975/1 datë 27.04.2023 “Transferim fondi për shpenzime kapitale” , për pagesën e TVSH dhe bashkëfinancim projekte me financim të huaj.
- 10,702,718 lekë akorduar me shkresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8321 datë 08.05.2023 “Dërgohet rritja e pagave për funksionet e financuara me transfertë sektoriale”, për të mbuluar efektin e rritjes së pagave në zbatim të VKM-ve nr. 240, 241 dhe 242 datë 20.04.2023.
- 2,341,673 lekë akorduar bashkisë Berat me shkresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 16500/1 datë 09.10.2023 “Transferim fondi për shpenzime kapitale”, për pagesën e TVSH dhe bashkëfinancim projekte me financim të huaj. Nga ky fond është detajuar me VKB shuma 1,839,947 lekë. Fondi prej 501,726 lekë nuk është shtuar si vlerë në buxhetin e detajuar me VKB, dhe është trashëguar në vitin 2024.

Transferta sektoriale e trashëguar nga viti 2022 është 94,178,141.41 lekë.

TRANSFERTA E KUSHTËZUAR

Transferta e kushtëzuar përbëhet nga fondet e deleguara për mbulimin e shërbimit të Gjendjes Civile, fondet për mbështetje me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë dhe për personat me aftësi ndryshe, fondet për projekte të veçanta .

Në vitin 2023 transferta e kushtëzuar e akorduar për bashkinë Berat është 893,257,123 lekë, si më poshtë :

Transferta të Kushtëzuar për funksione të deleguara

Transferta e kushtëzuara në buxhetin e vitit 2023, jepet për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara, shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore për kryerjen e shërbimit të Gjendjes Civile. Këto fonde përdoren nga njësitë e qeverisjes vendore vetëm për qëllimin për të cilin janë dhënë. Në periudhën raportuese janë akorduar fonde edhe për pagat dhe sigurimet e muajit 12/22 për Qendrën Kombëtare të Biznesit. QKB pushoi së funksionuari në 30/12/22, por pagesat për personelin janë akorduar dhe likuiduar në v.2023.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2023 është akorduar shuma 10,390,838 lekë .

Grup	Kod Programi	Llog.	Pershkrimi	Transferta Janar - Dhjetor2023
Qendra Kombetare e Biznesit				205,418
10	04130	600	Paga	176,023
10	04130	601	Sigurime Shoqërore	29,395
Gjendja Civile				10,185,420
16	01170	600	Paga	8,450,000
16	01170	601	Sigurime Shoqërore	1,410,000
16	01170	606	Pagesa e njoftuesve me shkrim te zgjedhesve per daten 14.05.2023	325,420
Total Transferta e Kushtëzuar për Funksiione të Deleguara				10,390,838

Fonde për Ndhimën Ekonomike për Pagesën e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe për Përkujdesjen Shoqërore.

Fondet e kushtëzuara për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe përkujdesjen shoqërore, janë fonde të Ministrisë së Linjës. Ato iu delegohen njërive të qeverisjes vendore të cilat bëjnë vlerësimin e nevojave si dhe kryejnë pagesat e ndihmën ekonomike, të personave me aftësi të kufizuar dhe për përkujdesjen shoqërore.

Për buxhetin e vitit 2023 transferta e kushtëzuar e akorduar për Bashkinë Berat është 455,113,000 lekë.

Grup	Kod Programi	Llog.	Pershkrimi	Transferta Janar- Dhjetor 2023	
PAGESA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR DHE PËR PËRKUJDESJEN SHOQËRORE NDIHMA EKONOMIKE				455,113,000	
13	10430	01	606	Transferta per Buxh. Fam. & Individe	453,570,396
13	10430	01	606	Shpenzime Vendim gjyqesor	378,604
13	10430	01	606	Transferat per Personelin e qendres "Streheza"	1,164,000
Total Transferta e Kushtëzuar për PAK dhe Nd. Ekonomike				455,113,000	

Transferta për projekte të veçanta

Në periudhën raportuese Bashkisë Berat i janë akorduar fonde në shumën 427,753,285 lekë për projekte të veçanta si më poshtë :

Grup	Kod Programi	Llog.	Pershkrimi	Transferta Janar-Dhjetor 2023	
Bashkia Berat (Aparati) 2102001				419,320,645	
Investime Projektim KUZ dhe Ndertim Ujesjelles				186,326,185	
06	06370	01	231	Ndertim i linjës kryesore dhe shpërndarjes së furnizimit me ujë Njësia Administrative Velabisht	33,577,200
06	06370	01	231	Supervizim "Ujesjellesi Velabisht"	1,019,744
06	06370	01	231	Kolaudim, Ujesjellesi i fshatit Velabisht	260,000
06	06370	01	231	Ujesjellesi i fshatit Duhanas, Lapardha 1, Otlak, Orizaj	138,719,770

06	06370	01	231	Supervizim Ndertim Ujesjellesi i fshatit Duhanas, Lapardha 1, Otlak, Orizaj	3,041,471
06	06370	01	230	Studim Projektim KUZ Lagja Uznove Rajoni III dhe Fshati Duhanas	9,708,000
Fonde per Strehimin					41,944,100
10	06190	01	606	Bonus qeraje	2,303,883
10	06190	01	231	Permiresimi i banesave per komunitete te varfra e te pafavorizuara, kontrata 2022-2023	12,291,375
10	06190	01	231	Permiresimi i banesave per komunitete te varfra e te pafavorizuara, kontrata 2023-2024	27,348,842
Fonde per Arsimin Parashkollor dhe te Mesem					171,541,270
11	09120	01	602	Femije ne nevoje qe perfitojne sherbim arsimor cilesor (bursa per nxenesit)	4,587,720
11	09230	01	602	Femije ne nevoje qe perfitojne sherbim arsimor cilesor (bursa per nxenesit)	3,536,000
11	09230	01	231	Ndertim shkolla "Babe Dude Karbunara"	157,490,300
11	09230	01	231	Mobilim shkolla "Babe Dude Karbunara"	5,927,250
Mbrojtja civile dhe emergjencat					14,649,890
17	10910	01	600	Fond per shperblimin e punonjesve te MZSH	1,980,000
17	10910	01	604	Mbrojtja civile dhe emergjencat	10,000,000
17	10910	01	604	Mbrojtja civile dhe emergjencat	2,669,890
Fondi per zgjedhjet vendore te dates 14.05.2023					4,859,200
73	01620	01	600	Pagesa e komisionereve ne zgjedhjet vendore te dt. 14.05.2023	4,442,000
73	01620	01	602	Transport i bazes materiale per zgjedhjet vendore te dt. 14.05.2023	381,200
73	01620	01	602	Qera ambiente per zgjedhjet vendore te dt. 14.05.2023	36,000
Drejtoria Arsimore Bashkia Berat 2102005					8,432,640
10	09230	01	606	Femije ne nevoje qe perfitojne sherbim arsimor cilesor	8,432,640
Total Fonde per Projekte te Vecanta					427,753,285

TË ARDHURA NGA SPONSORIZIMET

Bashkia Berat ka patur në dispozicion të ardhura nga Sponsorizimet (të ardhura jashtë limitit) për t'i përdorur specifikisht për objekte sipas marrëveshjeve/kontratave me sponsorizuesit. Nga viti 2022 u trashëguan 2,109,397.73 lekë nga sponsorizimet. Gjatë vitit 2023 u shtuan me 1,827,025.69 lekë. Në total të ardhurat nga sponsorizimet në periudhën Janar – Dhjetor 2023 janë 3,936,422.69 lekë.

Të ardhurat nga Sponsorizimet

në lekë

Grup	Kod Prog.	Llog.	Pershkrimi	Sponsorizimet Janar-Dhjetor 2023
06	03280	231	Blerje mjete fadrome per sistemin e ujitjes Bashkia Berat, spons. Ambasada Japoneze "Per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimi"	177,500
06	04520	231	Alpha Bank, sponsorizim per "Rikonstruksioni i Shatervanit ne parkun qendror"	205,000
06	06260	231	"Ndertimi i kendit te lojerave ne parkun Deshmoret e Kombit", spons. Ambasada Gjermane	939,000

06	06260	231	Sponsorizim FLAG Projekti "Siguria publike ne nivel vendor"	562,000
06	09120	231	"Kend sportiv dhe rekreativ ne shkollen Velabisht, Berat", sponsor. Save the Children	583,330
06		231	Total Investime me fonde nga Sponsorizimet	2,466,830
06	10661	600	PNUD , "Askush te mos mbetet si ju"	649,100
06	10661	601	PNUD , "Askush te mos mbetet si ju"	108,400
06	10661	602	PNUD , "Askush te mos mbetet si ju"	711,590
06	01110	602	Erasmus +	503
			Total projekte me fonde nga Sponsorizimet	3,936,422.69

FONDI I ZHVILLIMIT TË RAJONEVE

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe Programi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale.

1. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor.
2. Thirrjet për aplikim në Fondin e Zhvillimit të Rajoneve për vitin buxhetor mund të bëhen në Nëntor të vitit paraardhës.
3. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve nuk trashëgohet në vitin pasardhës buxhetor.

Programi buxhetor për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale në Fondin Shqiptar të Zhvillimit

Fondet për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, të parashikuara si program buxhetor në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, janë një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor.

Specifikimet, rregullat, kriteret për financimin e projekteve si dhe shpërndarja e Fondit për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale për financimim e projekteve të reja kryhen nga Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Bashkia Berat është përfituese e investimeve nga FSHZH, për objektet :

Nr.	Emërtimi i objektit	Viti i Fillimit	Viti i Përfundimit	Vlera e projektit
1	Ndërtimi i godinës së parkimit dhe hapësirave mbështetëse në Berat	2020	2023	322,088,705
2	Paketa 1 - Zona Goricë – Restaurimi i peizazhit historik urban të lagjes Goricë; – Rehabilitimi i shtegut të Kalasë së Goricës dhe krijimi i potencialeve turistike pranë monumentit – Krijimi i një parkimi makinash pranë Urës së Vjetër të Goricës	2020	2024	420,000,000
3	Restaurimi i peizazhit historik urban të sheshit të Selamllëkut, Restaurimi i peizazhit historik urban të Mangalemit, Rigjenerim i zonës përreth Muzeut Etnografik dhe rrugës "Mihal Komneno"	2022	2023	271,999,999
4	Përmirësim pamor i siluetës urbane përgjatë rrugës Antipatrea në Qendër të Qytetit	2022	2024	472,413,766
5	Ndërtim Ura e Bilçës	2023	2024	401,717,000
6	Ndërhyrje për përmirësimin e hapësirave publike të destinuar për aktivitete rekreative" Parku Antipatrea	2023	2024	138,759,219

2.2. SHPENZIMET

Buxheti i Bashkisë Berat i vitit 2023, fillestar, u miratua në shumën 1,282,484 mijë lekë .Krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2022 është planifikuar me rritje 71,157 mijë lekë, ose në masën 5.8 %.

Pas shtesës së buxhetit me fondet e trashëguara nga viti 2022, si edhe me fondet e akorduara shtesë, buxheti i vitit 2023 bëhet 1,606,890 mijë lekë.

Në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 , buxheti vjetor është realizuar në masën 74.2 %.

2.2.1 Realizimi i planit të shpenzimeve të periudhës Janar – Dhjetor 2023 sipas Njësive Shpenzuese

Buxheti i bashkisë Berat është planifikuar dhe realizuar në 6 njësi shpenzuese sipas programeve buxhetore që ato menaxhojnë. Përshatja e gjithë informacionit financiar është mbi bazën e strukturës së 9 fushave/funksioneve kryesore që janë përgjegjësi ligjore e njësisë së qeverisjes vendore sipas ligjit 139/2015, dhe 27 nënfunksioneve, sipas kodifikimit COFOG, i cili unifikon njëkohësisht dhe marrëdhënien me Qeverinë Qendrore /Degën e Thesarit.

Bashkia Berat siguron ofrimin e shërbimeve publike, sociale, komunitare, etj, nëpërmjet 6 Njësive Shpenzuese, të cilat menaxhojnë buxhetin në programet përkatëse :

1. Bashkia Berat menaxhon 53.6 % të totalit të buxhetit të bashkisë v.2023
2. Agjencia e Shërbimeve Publike menaxhon 17.8 % të totalit të buxhetit të bashkisë v.2023
3. Drejtoria e Arsimit menaxhon 21 % të totalit të buxhetit të bashkisë v.2023
4. Qendra Kulturore “Margarita Tutulani” menaxhon 2.8 % të totalit të buxhetit të bashkisë v.2023
5. Qendra “Lira” menaxhon 1.8 % të totalit të buxhetit të bashkisë v.2023
6. Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar menaxhon 3 % të totalit të buxhetit të bashkisë v.2023

Realizimi i shpenzimeve në total për Bashkinë Berat sipas njësive shpenzuese për vitet 2022 & 2023 paraqitet si më poshtë :

në 000/lek

Nr	Njësia Shpenzuese	Plan Buxheti i rishikuar 2022	% në strukturë	Fakt 2022	% në strukturë	Plan Buxheti Fillestar	Struktura	Plan buxheti me ndryshime	Struktura	Fakt	Realizimi
						2023	%	2023	%	2023	ne %
1	Bashkia Berat (Aparati)	649,403	47%	427,101	42%	640,381	49.9%	860,810	53.6%	551,729	64.1%
2	Agjencia e Shërbimeve Publike	284,193	21%	222,503	22%	226,330	17.6%	285,669	17.8%	236,750	82.9%
3	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	330,669	24%	275,364	27%	315,075	24.6%	338,159	21.0%	298,448	88.3%
4	Qendra Kulturore " M. Tutulani "	38,352	3%	32,504	3%	36,251	2.8%	45,427	2.8%	41,354	91.0%
5	Qendra "LIRA"	28,187	2%	24,134	2%	24,703	1.9%	28,756	1.8%	27,678	96.3%
6	Drejtoria e Bujqësisë	43,684	3%	33,782	3%	39,744	3.1%	48,069	3.0%	35,840	74.6%
	Total	1,374,489	100%	1,015,388	100%	1,282,484	100%	1,606,890	100%	1,191,800	74.2%

Njësia shpenzuese Bashkia Berat (qendra) ka plan buxhetin vjetor 860,810 mijë lekë, ose 53.6 % të buxhetit total të bashkisë. Në periudhën Janar – Dhjetor plan buxheti 860,810 mijë lekë është realizuar në shumën 551,729 mijë lekë ose në masën 64.1%.

Njësia shpenzuese Agjencia e Shërbimeve Publike ka plan buxhetin vjetor 285,669 mijë lekë, ose 17.8 % të buxhetit total të bashkisë. Në periudhën Janar – Dhjetor plan buxheti 285,669 mijë lekë është realizuar në shumën 236,750 mijë lekë ose në masën 82.9%.

Njësia shpenzuese Drejtoria Arsimore Bashkia Berat ka plan buxhetin vjetor 338,159 mijë lekë, ose 21 % të buxhetit total të bashkisë. Në periudhën Janar - Dhjetorplan buxheti 338,159 mijë lekë është realizuar në shumën 298,448 mijë lekë ose në masën 88.3%.

Njësia shpenzuese Qendra Kulturore “ M. Tutulani” ka plan buxhetin vjetor 45,427 mijë lekë, ose 2.8 % të buxhetit total të bashkisë. Në periudhën Janar - Dhjetorplan buxheti 45,427 lekë është realizuar në shumën 41,354 mijë lekë ose në masën 91%.

Njësia shpenzuese Qendra “LIRA”ka plan buxhetin vjetor 28,756 mijë lekë, ose 1.8 % të buxhetit total të bashkisë. Në periudhën Janar - Dhjetorplan buxheti 28,756 mijë lekë është realizuar në shumën 27,678 mijë lekë ose në masën 96.3 %.

Njësia shpenzuese Drejtoria e Bujqësisë ka plan buxhetin vjetor 48,069 mijë lekë, ose 3% të buxhetit total të bashkisë . Në periudhën Janar – Dhjetor plan buxheti 48,069 mijë lekë është realizuar në shumën 35,840 mijë lekë ose në masën 74.6 % . .

2.2.2 Realizimi i planit të shpenzimeve të periudhës Janar - Dhjetor 2023 sipas Natyrës Ekonomike

Shpenzimet buxhetore sipas natyrës ekonomike

në 000 lekë

Art.	Emertimi	Fakti i vitit paraardhes	Buxheti vjetor plan fillestar	Buxheti vjetor plan me shtesa	Struktura	Fakt	Realizimi i planit vjetor	Diferenca e perealizuar
		2022	2023	2023	%	2023	%	
600	Paga	431,844	523,284	542,615	34%	501,269	92.4%	41,346
601	Sigurime Shoqërore	73,154	86,837	91,951	6%	84,267	91.6%	7,684
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	334,851	348,071	453,965	28%	313,290	69.0%	140,674
603	Subvencione	33,000	35,000	35,000	2%	32,500	92.9%	2500
604	Transferta Korente të Brendshme	2,561	3,620	3,620	0.23%	3,230	89.2%	390.032
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0%	0		0
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individe	18,400	28,300	36,061	2%	8,680	24.1%	27,381
	Shpenzime Korrente (600-606)	893,810	1,025,112	1,163,211	72%	943,236	81.1%	219,975
230	Kapitale të Patrupëzuara	12,774	4,000	51,870	3%	17,587	33.9%	34,283
231	Kapitale të Trupëzuara	108,805	253,372	391,808	24%	230,976	59.0%	160,832
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0%	0		0
	Shpenzime Kapitale (230-232)	121,579	257,372	443,678	28%	248,564	56.0%	195,114
	Totali (korrente + kapitale)	1,015,388	1,282,484	1,606,890	100%	1,191,800	74.2%	415,090

Realizimi i planit të shpenzimeve të periudhës Janar – Dhjetor 2023 sipas artikujve buxhetorë :

Buxheti i Bashkisë Berat i vitit 2023, i rishikuar gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023 (pas shtesave e pakësimeve të bëra gjatë vitit me vkb) plan 1,606,890 mijë Lekë është realizuar me 1,191,800 mijë Lekë ose në masën 74.2 %. Diferenca e perealizuar e buxhetit vjetor është 415,090 mijë Lekë.

a. Shpenzimet korrente (personeli, shpenzime operative të mirëmbajtjes, të tjera transferata tek familje&individë)

Shpenzimet korrente vjetore të planifikuara (personeli, shpenzime operative të mirëmbajtjes, të tjera transferata), në shumën 1,163,211 mijë lekë , zënë 72 % të buxhetit total.

Shpenzimet korrente për periudhën Janar - Dhjetor 2023 u realizuan në vlerën 943,236 mijë Lekë kundrejt të planifikuarave në shumën 1,163,211 mijë lekë , ose në masën 81.1 %. Diferenca e perealizuar në vlerë e planit vjetor është 219,975 mijë Lekë.

b. Shpenzimet kapitale

Shpenzimet kapitale vjetore të planifikuara në shumën 443,678 mijë lekë, zënë 28 % të buxhetit total.

Shpenzimet kapitale për periudhën Janar - Dhjetor 2023 u realizuan në vlerën 248,564 mijë Lekë kundrejt planit të periudhës në shumën 443,678 mijë lekë, ose në masën 56 %. Diferenca e perealizuar në vlerë e planit vjetor është 195,114 mijë lekë

Artikulli 600 : Paga - është realizuar në masën 92.4 % e planit vjetor,

Raporti fakt/plan : 501,269 mijë lekë / 542,615 mijë lekë

Shpenzimet për paga të planifikuara për vitin 2023 janë 542,615 mijë lekë dhe janë realizuar 501,269 mijë lekë, ose në masën 92.4 %.

Pagat e të gjithë punonjësve janë paguar rregullisht çdo muaj sipas prezencave respektive në njësitë shpenzuese. Diferenca e perealizuar prej 41,346 mijë përfaqëson:

- fondin e veçantë, i cili është planifikuar në masën 1% të pagave , nga i cili është përdorur vetëm shuma 1,657 mijë lekë për shpërblime të punonjësve në rastet e veçanta të daljes në pension apo raste fatkeqësie.

- fondet e papërdorura për shkak të vendeve vakante në strukturë. Numri i punonjësve në strukturën e bashkisë për vitin 2023 është 787 dhe numri faktik mesatar është 741, vende vakante 46; struktura e plotësuar në masën 94%.

Numri i punonjësve të Bashkisë Berat sipas njësive shpenzuese, periudha Janar – Dhjetor 2023 :

Nr	Njësia Shpenzuese	Plan numri i te punesuarve	Nr mesatar i te punesuarve	vende vakante	% e realizimit	Plan numri i te punesuarve	Nr mesatar i te punesuarve Fakt	vende vakante	% e realizimit
		2022	2022	2022	2022	2023	2023	2023	2023
1	Bashkia Berat (Aparati)	200	176	24	88%	208	179	31	86%
2	Agjencia e Shërbimeve Publike	150	139	11	93%	148	141	7	95%
3	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	334	332	2	99%	334	334	0	100%
4	Qendra Kulturore " M. Tutulani "	29	25	4	86%	29	25	4	86%
5	Drejtoria e Bujqesise	40	38	2	95%	45	39	6	87%
6	Qendra "Lira"	23	23	0	100%	23	23	0	100%
	TOTALI	776	733	43	94%	787	741	48	94%

Numri i punonjësve të Bashkisë Berat sipas programeve buxhetore, periudha Janar – Dhjetor 2023 :

Kod Institucioni	Kod Programi	Emërtimi i Programit	Numri i Punonjësve	Numri mesatar i punonjesve
			Plan 2023	Fakt 2023
2102001	Bashkia Berat (Aparati/qendra)		208	179
2102001	01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	132	114
2102001	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	17	13
2102001	03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	38	32
2102001	10430	Përkujdesja/Mbrojtja Sociale	18	17
2102001	10661	Strehimi social	3	3
2102004	Agjencia e Shërbimeve Publike		148	141
2102004	04520	Rrjeti rrugor	46	44
2102004	06260	Shërbimet publike vendore	102	97
2102005	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat		334	334
2102005	09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	250	250
2102005	09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	38	38
2102005	10430	Përkujdesja/Mbrojtja Sociale	46	46
2102006	Qendra Kulturore "Margarita Tutulani"		29	25
2102006	08130	Sport dhe argëtim, Q. Kulturore	2	2
2102006	08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore, Q. Kulturore	27	23
2102022	Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve , Ujërave dhe Shërbimit Veterinar		45	39
2102022	04220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	21	16
2102022	04240	Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	14	13
2102022	04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	10	10
2102020	Qendra "Lira"		23	23
2102022	10430	Përkujdesja/Mbrojtja Sociale	23	23
Total			787	741

Artikulli 601 : Sigurime shoqërore - është realizuar në masën 91.6 % e planit vjetor

Raporti fakt/plan : 84,267 mijë lekë / 91,951 mijë lekë

Shpenzimet për Sigurime shoqërore të planifikuara për vitin 2023 janë 91,951 mijë lekë dhe janë realizuar 84,267 mijë lekë, ose 91.6 %. Mosrealizimi lidhet me vendet e lira në strukturë.

Të gjitha njësitë shpenzuese kanë paguar rregullisht çdo muaj detyrimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, duke mos krijuar detyrime ndaj DRT.

Totali i shpenzimeve të personelit (art 600+601) : është realizuar në masën 92.2 % e planit vjetor

Shpenzimet e personelit për vitin 2023 janë planifikuar në shumën 634,566 mijë lekë dhe zënë 39.5 % të plan buxhetit total.

Për periudhën 2023 buxheti i shpenzimeve të personelit është realizuar në vlerën 585,536 mijë lekë, ose në masën 92.2 %.

Realizimi 92.2% është për arsye të mosplotësimit të strukturës së punonjësve me numrin maksimal të planifikuar, mbi bazën e të cilit është bërë edhe përlllogaritja e fondit të pagave. Si edhe nga mospërdorimi i fondit të veçantë (sikurse sqaruar në paragrafët më sipër).

Artikulli 602 : Mallra dhe shërbime të tjera – Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë realizuar në masën 69 % e planit vjetor

Raporti fakt/plan : 313,290 mijë lekë / 453,965 mijë lekë

Shpenzimet për Mallra dhe Shërbime të tjera të planifikuara për vitin 2023 janë 453,965 mijë lekë dhe zënë 28% të plan buxhetit total vjetor.

Për periudhën 2023 buxheti i shpenzimeve për Mallra dhe shërbime të tjera është realizuar në vlerën 313,290 mijë lekë, ose në masën 69 %.

Diferenca e parealizuar e planit vjetor është 140,674 mijë lekë. Në vijim të materialit jepet informacion më i detajuar i realizimit të shpenzimeve sipas programeve buxhetore.

Artikulli 603 : Subvencione – Shpenzimet për Subvencione janë realizuar në masën 93 % e planit vjetor

Raporti fakt/plan : 32,500 mijë lekë / 35,000 mijë lekë

Shpenzime të planifikuara për vitin 2023 janë 35,000 mijë lekë dhe zënë 2 % të plan buxhetit vjetor.

Për periudhën 2023 janë realizuar 32,500 mijë lekë, ose në masën 93% e planit vjetor.

Këto shpenzime përfaqësojnë shumën e subvencionuar për sh.a. “FK Tomori 1923”, ku Bashkia Berat zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë. Transferimi i fondeve është bërë sipas kërkesave të paraqitura çdo muaj nga sha FK Tomori 1923 për financimin e shpenzimeve të domosdoshme.

Artikulli 604 : Transferta korrente të brendshme - Shpenzimet për Transferat korrente të brendshme janë realizuar në masën 89 % e planit vjetor .

Raporti fakt/plan : 3,230 mijë lekë / 3,620 mijë lekë

Shuma e parashikuar për shpenzime në këtë artikull buxhetor për vitin 2023 është 3,620 mijë lekë dhe zë 0.23% të plan buxhetit vjetor.

Realizimi vjetor është 3,230 mijë lekë, ose në masën 89%.

Në transfertat e Bashkisë Berat përfshihen :

1. Detyrim kontraktual ndaj Ndërmarrjes Ujësjellës-Kanalizime në rolin e agjentit tatimor për arkëtimin e tarifave vendore nga familjet nëpërmjet faturës mujore të ujit. Plani vjetor 2,250 mijë lekë është realizuar në shumën 2,217 mijë lekë ose 99% e planit vjetor.
2. Transfertë për Drejtorinë Rajonale të Tatimeve për tatimin e thjeshtuar dhe Tatimit mbi të ardhurat personale (1 % mbi shumën e arkëtuar sipas përcaktimit ligjor). Plani vjetor prej 20 mijë lekë është realizuar në shumën 13 mijë lekë ose në masën 65 %.
3. Transfertë për Këshillin e Qarkut (kuotë), planifikuar sipas ligjit 68/2015 “Për vetëqeverisjen vendore, neni 38 pika 3, planifikuar total 1,000 mijë lekë. Realizimi 1,000 mijë lekë, ose 100 %.

**Artikulli 606 : Transferta për buxhetet, familjet dhe individët - është realizuar në masën 24 % e planit vjetor
Raporti fakt/plan : 8,680 mijë lekë / 36,061 mijë lekë**

Shpenzimet për Transferat për buxhetet, familjet dhe individët janë realizuar në masën 24 % e planit vjetor.

Janë parashikuar në këtë artikull buxhetor shpenzime në shumën vjetore 36,061 mijë lekë dhe janë realizuar 8,680 mijë lekë.

Në këtë artikull përfshihen : **Fondi rezervë, fondi i kontingjencës, fondi i emergjencave civile dhe i mbrojtjes civile**. Po ashtu edhe transfertat tek familje apo individë për : bonus strehimi/subvencion qeraje, trajtimi me ndihmë ekonomike i rasteve të veçanta nga fondet e bashkisë, dhënie ndihme financiare për individë në raste të veçanta. Në të gjitha rastet përdorimi i fondeve është bërë me miratim të Këshillit Bashkiak.

Fondi Rezervë : Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe nenit 6 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore, krijohet Fondi rezervë.

Në buxhetin e vitit 2023 është planifikuar fond rezervë në shumën 2,500 mijë lekë. Fondi Rezervë nuk është përdorur në periudhën Janar – Dhjetor 2023.

Fondi i Kontingjencës : Për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet Fondi i Kontingjencës. Të dy këto fonde miratohen në masën deri në 3 (tre) % të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara . Fondi i Kontingjencës i programuar në shumën 2,500 mijë lekë nuk është përdorur .

Fondet e Emergjencës dhe për Mbrojtjen Civile : Në zbatim të nenit 65 të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” , fondi i emergjencave civile planifikohet në shumë totale minimalisht 4 % të totalit të buxhetit të Bashkisë, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.

Në buxhetin e bashkisë u parashikuan nga të ardhurat e veta fonde për emergjencën dhe mbrojtjen civile në shumën 17,000 mijë lekë, të cilat u shtuan edhe me transfertën për mbrojtjen civile të trashëguar nga viti 2022 në shumën 3,491 mijë lekë.

Në periudhën Janar – Dhjetor 2023 është përdorur fondi i mbrojtjes civile (progr.03280, art. 606) në shumën 299,208 lekë për mbështetje financiare për 2 raste(familje), banesat e të cilave janë dëmtuar nga rënia e zjarrit. Përdorimi i këtij fondi është miratuar nga Këshilli Bashkiak me VKB nr. 23 dt. 11.04.2023 .

Në muajin mars 2023, nga buxheti qendror janë akorduar fonde të kushtëzuara në shumën 12,669,893.43 lekë me shkresën e Ministrisë së Mbrojtjes nr 86/6 prot datë 27.03.2023 “Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2023”. Ky fond përdoret për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të ligjit nr 45/2019. Ky fond është përdorur/realizuar në masën 9,988,035 lekë .

Në periudhën Janar – Dhjetor 2023, me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.15 datë 19.07.2023 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit të mbrojtjes civile” , në përputhje me VKM nr 414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, është miratuar të përdoret :

- shuma 10,000,446.41 lekë për projektin “Ndërhyrje rehabilituese në mure mbajtës dhe terrene në territorin e bashkisë, në kuadër të mbrojtjes civile”,

Këto ndërhyrje shërbejnë për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese , mbrojtëse dhe rehabilituese në objektet infrastrukturore që përbëjnë një kërcënim serioz për jetën e njerëzve, pronave të tyre dhe mjedisin, të cilat ndikojnë në rikthimin e jetës normale për komunitetin dhe veprimtaritë e tij ekonomike .

Nisur nga verifikimet në terren të zonave të riskut të cilat përbëjnë rrezik për jetën e qytetarëve, si dhe kërkesave të vazhdueshme të tyre për rrezikshmërinë që paraqesin muret mbajtëse dhe terrene në tre lagje të Bashkisë Berat, ishte e nevojshme për ndërhyrje në 3 objekte, konkretisht :

- ✓ Lagjja “ Barrikadë“ Depo e Ujit, Rajoni nr 1, ka patur përmbysje të murit ekzistues te gurit. Si pasojë rruga që ndodhet mbi murin ekzistues dhe mbushja e murit rrezikonin shëmbjen duke cënuar integritetin strukturor të banesave përreth. Në këto banesa strehohen tre familje të cilat momentalisht janë të strehuara në banesa me bonus qeraje.

Ndërhyrje me vlerë të përlogaritur 2,011,605.3 lek me tvsh.

- ✓ Lagjja “ Muzakaj “ Gropa e Zhurit , Rajoni nr 1, skarpoti që ndodhet mbi objektet ekzistuese rrezikon objektet rezidenciale që ndodhen nën te si pasojë e rënies së gureve.

Ndërhyrje me vlerë 7,206,119.35 lek me tvsh.

- ✓ Lagjja “ 28 Nëntori “ , Rajoni 2 në rrugën paralele me rrugën “ Veri Zaloshnja “ , pranë qendrës së qytetit, mungojnë muret mbajtëse përgjate rruges , duke rrezikuar stabilitetin e rrugës dhe shëmbjen e banesave.

Ndërhyrje me vlerë 782,721.75 lek me tvsh.

Nga procedura e prokurimit kontrata është lidhur me vlerën 7,165,591 lekë, e cila u realizua plotësisht.

Me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.51 datë 30.11.2023 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit të mbrojtjes civile”, në përputhje me VKM nr 414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, është miratuar të përdoret fondi 2,834,409 Lekë për ndërhyrje emergjente sipas projektit “Ndërtim i shpatullave të Urës në fshatin Lapardha”, realizuar 2,822,444 Lekë.

Bonus strehimi/Subvencion qeraje : Buxheti vjetor i planifikuar është 3,800 mijë lekë. Në periudhën Janar - Dhjetor është realizuar shuma 3,027 mijë lekë , ose 80 % e buxhetit vjetor, për pagesë bonus qeraje, për të gjitha rastet e miratuara .

Shërbime sociale : Plani vjetor është 5,130 mijë lekë. Realizimi për periudhën Janar – Dhjetor është 3,696 mijë lekë, ose në masën 72 % të plan buxhetit vjetor. Fondet janë përdorur për trajtim me ndihmë ekonomike rastet e veçanta shuma 3,256 mijë lekë , si edhe për dhënie ndihmë financiare në rast fatkeqësie për 8 raste, individë në kushte të vështira shuma 440 mijë lekë.

Fondi i veçantë : Në këtë zë shpenzimesh është përdorur fondi i veçantë në shumën 1,657 mijë lekë, për shpërblime të punonjësve në rastet e veçanta të daljes në pension apo raste fatkeqësie, sipas kritereve ligjore dhe urdhërit të titullarit.

Artikulli 230&231 : Shpenzime kapitale të patrupëzuara dhe të trupëzuara – është realizuar në masën 56 % e planit vjetor.

Raporti fakt/plan : 248,564 mijë lekë / 443,678 mijë lekë

Shuma e parashikuar për shpenzime kapitale për vitin 2023 është 443,678 mijë lekë dhe zë 28% të plan buxhetit vjetor.

Për periudhën 12-mujore janë realizuar 248,564 mijë lekë, ose në masën 56% e buxhetit të planifikuar.

Informacion i detajuar mbi realizimin e investimeve për periudhën Janar – Dhjetor 2023:

Projektet e Investimeve me financim nga Buxheti i Bashkisë

Tabela e realizimit të investimeve sipas programeve buxhetore në lekë

Emertimi i projektit	Kodi i Instituc.	Kodi i projektit	Plani i buxhetit viti 2023	Realizimi për periudhën e raportimit	Realizimi ne %
Programi 01110 Planifikim Menaxhim, Administrim			25,728,000	11,464,357	45%
Kredia e banesave sociale	2102001	1020034	7,200,000	6,173,917	86%
Pajisje Aparati i Bashkise (Pajisje zyre, kompjuterike, softëare)	2102001	1020022	3,528,000	1,156,800	33%
Rikonstruksion dhe arredim i zyrave te njesive administrative te bashkise Berat, ambientit te pritjes se delegcioneve te huaja dhe salle mbledhjesh	2102001	1020195	15,000,000	4,133,640	28%
Programi 03280 Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	8,408,004	4,080,600	24,884,970	22,523,436	91%
Bashkefinancim per projektin "FIRE PREP Permiresimi i sherbimit te mbrojtjes nga zjarri" financim i perkohshem i rimbursueshem nga donatori	2102001	1020186	4,993,810	4,993,810	100%
Pagese Bashkefinancimi per projektin me financim te huaj "FIRE PREP Permiresimi i Mbrojtjes nga zjarri ne pyje ne Shqiperi dhe Greqi", i financuar nga BE nepermjet Programit Nderkufitar Greqi-Shqiperi, fond MFE	2102001	1020186	8,751,272	8,282,796	95%
Pagese TVSH-je te projekteve me financim te huaj "FIRE PREP Permiresimi i Mbrojtjes nga zjarri ne pyje ne Shqiperi dhe Greqi", i financuar nga BE nepermjet Programit Nderkufitar Greqi-Shqiperi, fond MFE	2102001	1020186	10,969,888	9,156,830	83%
Blerje pajisje	2102001	1020042	170,000	90,000	53%
Programi 04240 Menaxhimi I infrastruktures se ujitjes dhe kullimit			4,907,433	2,583,184	53%
Blerje pajisje elektronike	2102022	1020206	150,000	117,032	78%
Rikonstruksion (veshje me beton) e kanalit vadites Lapardha	2102022	1020179	2,557,433	2,466,152	96%
Blerje mjet transporti mallrash (per transportin e druve)	2102022	1020107	2,200,000	0	0%
Programi 04260 Administrimi i pyjeve dhe kullotave			585,518	0	0%
Ndertim Lera malore ne fshatin Mbjeshove	2102022	1020188	585,518		0%
Programi 04520 / 230 Rrjeti rrugor (Hartim projektesh)			51,869,800	17,587,287	34%
Hartim projekte, studime, VNM	2102001	1020107	35,000,000	1,117,599	3%
Oponence teknike per objekte ndertimi	2102001	1020107	1,145,000	744,888	65%
Hartim projektesh "Mbrojtja lumore pergjatë lumit Osum", "Ndërtim trotuari & ndricimi i rrugës Shpiragu" dhe "Ruga e re Shkëmbi", kontrata 2023-2024 (15.048.000=9.028.800+6.019.200)	2102001	1020107	9,028,800	9,028,800	100%
